



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 64, datë 22/12/2004

**“PËR KALIMIN NË FOND BANESE
TË ISH-ZYRAVE TË NDËRMARRJES SË PRODHIM VESHJEVE NR.1,
PAJISJE ME AUTORIZIM DEFINITIV DHE PRIVATIZIM TË BANESËS
PËR QYTETARIN PELIVAN KAPLLANI”**

Këshilli Bashkiak i Tiranës pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore “Për kalimin në fond banese të ish-zyrave të Ndërmarrjes së Prodhim Veshjeve Nr.1, pajisje me autorizim definitiv dhe privatizim të banesës për qytetarin Pelivan Kapllani”, mbështetur në ligjin Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, gërma “e”, në ligjin Nr.7652, dt.23/12/1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, në Dekretin e Presidentit Nr.1440, dt.04/04/1996 “Për trajtimin e banesave shtetërore të paprivatizuara”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.153, dt.03/04/1993 “Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjes dhe institucioneve shtetërore”, në ligjin Nr.8030, dt.15/11/1995 “Për kontributin e shtetit për familjet e pastreha”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.49, dt.29/01/1993 “Për përcaktimin e kriterëve për të pastrehët”,

V E N D O S I;

1. Të kalojë në fond banese ish-zyrat e ndërmarrjes së Prodhim Veshjeve Nr.1, sipas genplanit bashkëlidhur.
2. Të pajiset me autorizim definitiv qytetari Pelivan Kapllani për strukturën 3+1, sipas planimetrisë bashkëlidhur.
3. Të bëhet privatizimi sipas pikës 2 të këtij Vendimi.
4. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore dhe Ndërmarrja Komunale Banesa.
5. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI